



Organizata jo-qeveritare Çelnaja
ngogelnaja@yahoo.com www.celnaja.org

Monitorimi i Zbatimit të PVPE – së

Përkrahur nga KFOS

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosova Foundation for Open Society

*Prishtinë,
Korrik 2009
©Çelnaja*

Shtypin e këtij raporti e mundësoi:



Distancim nga përgjegjësia!
Ky raport nuk pasqyron domosdo pikëpamjet e KFOS

©Çelnaja

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
Metodologjia.....	6
Progresi pas Raportit të Progresit.....	7
Integrimi Evropian dhe Koordinimi ndërinstytucional:	12
Komunikimi (Thembra e Akilit).....	17
Sfidat dhe Rekomandimet.....	21
Përfundim	23
Fakte të Shpejta.....	25

HYRJE:

Pas zgjidhjes së çështjes se statusit të Kosovës, procesi i integritimit në Bashkimin Evropian – BE pritet të përbëjë synimin më të rëndësishëm për Kosovën. Integrimi i një vendi në Bashkimin Evropian është një rrugë e gjatë, e vështirë dhe e sfidueshme. Rrugja drejt integritimit është një proces i gjatë dhe i komplikuar pasi që ka të bëjë me përmbushjen e kriterëve dhe standardeve të cilat nuk janë lehtësisht të arritshme për një vend të pa zhvilluar, dhe i cili njëkohësisht përballet me shtet-ndërtim dhe integrim. Kjo situatë vështirësohet edhe më shumë kur kihet parasysh fakti që Kosova ende përballet me probleme që lidhen me njohjen e saj nga të gjitha shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, por veçanërisht nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian (*Sllovakia, Greqia, Qipro, Rumania dhe Spanja janë vende që nuk e kanë njohur Kosovën*), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - OSBE, dhe Traktatit të Vendeve të Aleancës Veriatlantike – NATO. Problemi i njohjes vështirëson dhe ngadalëson afirmimin ndërkombëtar të Kosovës duke dëmtuar kështu avancimin e pozicionit të vendit në bashkësinë ndërkombëtare. Si pasojë, dëmtohen mundësitë për përfitim më të madh politik, ekonomik dhe social të vendit nga përkrahja ndërkombëtare.

Procesi i ecjes së Kosovës drejt integritimit në BE është një proces i cili në vete përmban nevojën për përmbushjen efikase të kriterëve politike, ekonomike, tregut të brendshëm, politikave sektoriale, drejtësisë dhe sigurisë, si dhe kushtet që prekin bashkëpunimin e Kosovës me vendet fqinje. Në njërën anë, nga ana e Bashkimit Evropian procesi bazohet në përkrahjen që i ofrohet Kosovës dhe kushtet që kjo duhet përmbushur, kurse në anën tjetër procesi bazohet edhe në përmbushjen e suksesshme të këtyre kushteve nëpërmes veprimeve konkrete si dhe fuqizimit të kapaciteteve administrative në rrugën e përmbushjes së kriterëve të kërkuara për të qenë më afër kandidaturës dhe pas kësaj anëtarësimit në vetë Bashkimin Evropian. Për momentin gjendja e të arriturave të deritashme, në rastin më të keq e zhvendos Kosovën shumë vite larg mundësisë reale për t'u integruar në BE, ndërsa në rastin më të mirë, disa vite larg këtij integritimi.

Aktualisht, marrëdhënia e Kosovës me Bashkimin Evropian është kornizuar brenda Mekanizmit Përcjellës së Stabilizim Asociimit, ku ndër dokumentet më të rëndësishme paraqitet Plani i Veprimit për Partneritet Evropian – PVPE. Qeveria e Kosovës ka aprovuar këtë dokument strategjik të integritimit sipas të cilit en dhe afatizohen veprimet dhe masat

që duhet ndërmarrë, parashikohen burimet financiare të cilat mbështesin përmbushjen e këtyre veprimeve, identifikohen institucionet përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve, si dhe parashihet forma e adresimit të përbashkët të veprimeve nga ana e institucioneve. Nëpërmes PVPE-së, kryesisht, reflektohet vullneti dhe gatishmëria politike dhe teknike e qeverisë dhe institucioneve tjera në ndërmarrjen me përkushtim dhe seriozitet të veprimeve, në mënyrë që të shënohet progres më i madh në rrugën e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. PVPE është dokument i cili hartohet mbi sugjerimet dhe kërkesat e Partneritetit Evropian për Kosovën, por përfshinë në mënyrë të pashkëputur edhe vlerësimet e Komisionit Evropian, të bëra në raportin e për-vjetshëm të progresit, apo në mënyrë dhe forma tjera nëpërmes prezencës dhe dialogut të vazhdueshëm me institucionet e Kosovës. Duhet theksuar se institucionet vendore konsiderohen meritore për sukseset, por njëkohësisht edhe përgjegjës kryesor për dështimet në proces të përmbushjes së veprimeve të parapara në këtë dokument. PVPE hartohet dhe modifikohet në baza një vjetore nga ana e ekzekutivit të Kosovës në mënyrë që të vlerësohet suksesi, të përmirësohet planifikimi dhe të rifreskohen të dhënat (veprimet), por këto ndryshime në këtë dokument jo gjithmonë arrijnë qëllimin të cilit i shërbejnë, që është përparimi dhe arritja e standardeve evropiane.

Kur jemi te PVPE, duhet theksuar se ky dokument paraqet kompleksitetin e proceseve integruese për Kosovë, pasi që përafërsisht 1600 veprime parashihen të ndërmerren, e të cilat sipas vlerësimeve fillestare mund të arrijnë apo edhe kalojnë shifrën e 1 miliard euro në aspektin afatmesëm. Këto veprime shpesh nuk pasqyrojnë mundësitë konkrete të institucioneve dhe shoqërisë sonë që ato të përmbushen me sukses. Faktorët që ndikojnë negativisht janë mungesa e burimeve njerëzore, financiare, komunikimi dhe bashkëpunimi i dobët ndër-institucional, transparenca e pamjaftueshme, hapësira e pamjaftueshme e punës si dhe mungesa e vullnetit politik, pastaj mungesa e infrastrukturës së përgjithshme dhe njohurive të nevojshme për të përparuar në këtë proces. Mospërmbushja e veprimeve të parapara si rezultat i faktorëve të lartpërmendur, nuk i justifikojnë institucionet e vendit dhe të gjitha palët tjera të përfshira në këtë proces për dështimet e tyre.

Organizata jo-qeveritare Çelnaja, ka zgjedhur monitorimin si mënyrë që të angazhohet në ofrimin e kontributit të saj në nivel jo qeveritar, duke ofruar argumente, shpjegime, informacione dhe konstatime që lidhen me procesin e integritetit. Çelnaja ka për fokus

monitorimin e një pjese të rëndësishme të PVPE-së, më saktësisht kapitullit i cili përmban kriteret politike. Ky kapitull përbënë një rën ndër pjesët më të rëndësishme të PVPE-së

Në procesin e monitorimit të PVPE-së organizata jo qeveritare Çelnaja ka përcaktuar tri prioritete kryesore: 1. Monitorimin e punës së institucioneve përgjegjëse për hartimin e ligjeve me rëndësi për fushën që monitorojmë, 2. Monitorimin e institucioneve bartëse të procesit të integritit evropian në mënyrë që të vlerësohet për së afërmi aspekti se si marrin formë zhvillimet në lidhje me caktimin e prioriteteve, organizimin dhe mbarëvajtjen e koordinimit si dhe adresimin e sfidave që dalin gjatë procesit të integritimeve, sfida këto që përmend edhe raporti i fundit i progresit i Komisionit evropian për Kosovën dhe 3, të konsultohet me njohësit e fushës në lidhje me të arriturat dhe dështimet lidhur me PVPE-në. Edhe pse jo pjesë e monitorimit, në këtë raport janë përfshirë edhe shumë aspekte të tjera që janë të ndërlidhura me integritimin evropian, këtu hyjnë dokumente, konferenca dhe ngjarje me rëndësi që kanë shoqëruar procesin e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Çelnaja nuk paragjykon kapacitetet e institucioneve për përmbushjen apo jo të veprimeve që dalin nga PVPE, e as rëndësinë që ka një veprim i caktuar në krahasim më ndonjë veprim tjetër brenda PVPE-së. Mirëpo, në varësi të kufizimeve kohore dhe gjendjes reale në terren, provon të ruaj përqendrimin dhe nivelin adekuat të monitorimit, në mënyrë që të arrijë në përfundime sa më objektive dhe më të pa anshme. Për këtë qëllim, Çelnaja komunikon dhe konsultohet vazhdueshëm me njohës të fushës dhe jo vetëm më palë të përfshira të cilat i monitorojmë.

Të dhënat në këtë raport synojnë të ofrojnë një pasqyrë reale të përmbushjes së obligimeve të dala nga dokumenti i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian dhe më gjerë dhe kanë për qëllim që të shpërbëjnë si burim i pa anshëm i informacionit për palët e përfshira në proces, në mënyrë që të kenë më shumë mundësi që të reflektojnë për procesin e integritimeve, të informojnë mediat dhe publikun e gjerë me interes për këtë proces, si dhe t'u shërbejë të interesuarve tjerë brenda dhe jashtë Kosovës për përdorim me të gjerë në varësi të nevojave kur bëhet fjalë për Kosovë.

METODOLOGJIA:

Qasja e përgjithshme dhe specifike: Faktor i rëndësishëm në procesin e monitorimit është padyshim edhe metodologjia e cila përdoret. Në këtë kuptim, si dhe duke pasur parasysh veçantitë që paraqesin proceset integruese, Çelnaja ka përdorë metodologji të njohur për monitorimin e progresit në teren, sikurse janë intervistat dhe konsultimi i materialeve me të cilat shërbehen institucionet, por duke mos u ndalur vetëm në këto. Konsultimi i njohësve të fushës së integriteteve, por edhe i ekspertëve të fushave specifike, përfshirë këtu edhe krahasimin e procesit në Kosovë me shembuj tjerë, është përdorur si praktikë e mirë që ndihmon në hartimin dhe përmbajtjen sa më cilësore të raportit. Në varësi të specifikave janë paraparë edhe forma tjera, si bie fjala, analizimi i artikujve medial apo është konsultuar edhe opinioni i organizatave tjera me të cilat ndërthuret monitorimi i ynë.

Pjesëmarrja në ngjarje publike me karakter raportues në mënyrë që të krahasohet informacioni me të dhëna të natyrës së ngjashme kur është fjala për integrimin, është paraparë si praktikë të cilën e kemi zbatuar në proces të monitorimit. Këto janë format të cilat ne i kemi paraparë si qasje e përgjithshme e monitorimit. Ndërsa sa i përket specifikave më të veçanta, Çelnaja ka paraparë plane të brendshme të veprimeve, identifikim të përgjegjësve për veprimet, krahasim i informacioneve kundërthënëse në terren, duke u siguruar që informacioni të jetë sa më korrekt dhe real. Çelnaja ka ndërtuar shtyllat në të cilat bazohet qasja e përgjithshme dhe shtyllat për qasjen më specifike për procesin e monitorimit. Puna monitoruese në terren dhe ajo analitike në zyrë kanë rezultuar me përmbledhjen e çështjeve me rëndësi të nxjerra në këtë raport. Vlen për tu veçuar një praktike e re e futur në këtë proces që është diskutimi i informacioneve me palët e përfshira, por edhe me të tjerë, në mënyrë që raportimi të minimizoj sa më shumë aspektin subjektiv.

PROGRESI PAS RAPORTIT TE PROGRESIT ?

Proceset Ligjbërëse: Në monitorimin e procesit të nxjerrjes së ligjeve vihen re mangësi të ndjeshme. Mangësi të cilat lidhen me punën e zyrtarëve, koordinimin ndër-institucional, konceptimin dhe rëndësinë që paraqesin integritet, apo kapaciteti dhe motivimi i zyrtareve. Si pasojë, miratimi më cilësor dhe efikas i ligjeve është një nga fushat e cila ndikohet negativisht në këtë drejtim. Në nivel qendror, në përgatitjen e ligjit për Qeverinë e Kosovës është vënë re se Qeveria e Kosovës në raport me Kuvendin nuk ka shfaqur interes të theksuar që në kohë dhe mënyrë të duhur të përfshijë kontributin e përfaqësuesve të opozitës. Opozita e konsideron këtë ligj tejte të rëndësishëm për shkak se qeveritë ndërrohen, por ligji mbetet, dhe për të iu shmangur komplikimeve të mëvonshme ky ligj do të duhej konsultuar edhe nga opozita gjatë fazës së draftimit. Në draftimin e këtij ligji, *draftuar nga zyra ligjore në Ministrinë e Shërbimeve Publike (tash Ministria e Administratës Publike)*, kanë marrë pjesë një shtresë e selektuar e institucioneve dhe shoqërisë civile, duke ikur kështu nga diskutimi dhe debati mbi këtë ligj. Kuvendi i Kosovës nuk do të duhej konsideruar vetëm si institucion i kalimit të ligjeve, por edhe i ndikimit substancial në proces të përpilimit dhe nxjerrjes së tyre, e njëjta gjë venë edhe për shoqërinë civile si dhe partitë politike të cilat mund dhe duhet të marrin pjesë në diskutimet në draftimin e ligjeve pasi që kjo vetëm sa i ndihmon përpilimit sa më gjithëpërfshirës të tyre.

Dihet mirëfilli se konsultimi i opinionit të përfaqësuesve të opozitës me qëllim të përfshirjes së kontributit të tyre, por edhe përafrimit të pozicioneve të kundërta mes subjekteve politike, vetëm sa do të pasuronte aktin e finalizimit, pra debatin në seanca të hapura, duke ngritur efikasitetin dhe cilësinë e veprimeve të Qeverisë dhe Kuvendit.

Është vënë re se nuk janë ndërmarrë përpjekje të vendosura që shoqëria civile dhe ekspertet përkatës të jenë përfshirë në nivelin që kërkohet, edhe pse ka raste të rralla kur institucione të caktuara provojnë që të përvetësojnë praktikën e përfshirjes dhe konsultimit të sektorëve tjerë jashtë institucional.

Sigurisht se ky është një proces i cili varet shumë nga vullneti dhe orientimi bashkëpunues i forcës politike në pozitë, por në procesin e përpilimit të ligjeve, përvetësimi i një qasje të ngushtë dhe jo të hapur kundrejt opozitës dhe palëve tjera, duke mos i përfshirë sa dhe si duhet në proces të përpilimit dhe konsultimit të opinionit të tyre,

dëmton dukshëm substancën e ligjeve që nxirren, sikurse dëmton edhe aspektin afatgjatë të zbatimit të tyre pastaj.

Një shqetësim tjetër është mungesa e shpërndarjes së informacionit për deputetët në lidhje me zhvillimet dhe stadin në të cilën gjenden ligjet në përpilim, apo edhe në lidhje me kompetencën e zyrtarëve që përpilojnë ligjet. Në këtë mënyrë rrjedh shqetësimi i opozitës se ligjet nuk pasqyrojnë si duhet qëllimin për të cilin janë hartuar. Një fakt i tillë lehtë vërtetohet nëse konsultohen komisionet parlamentare të cilat nuk kanë dijeni për ligjin derisa ai të vijë në komision. Shembull: edhe pse ligjet për gjyqësorin janë vonuar me vite, Komisioni për Gjyqësi dhe Legjislacion nuk informohet nga hartuesi për fazën në të cilën gjenden këto ligje apo edhe për shkaqet e vonësës së tyre.

Mos përfshirja e duhur e përfaqësuesve të opozitës por edhe e shoqërisë civile si dhe ekspertëve nga ana e institucioneve bartëse për ligjet që përpilohen, krijon te këta përfaqësues ndjesinë e neglizhimit dhe dominimit. Kjo dëmton procesin ligjbërës cilësor. Prandaj, kur kemi parasysh kapacitetet e kufizuara të ligj-bërjes në Kosovë kjo qasje e ngushtë, dëmton si procesin e nxjerrjes së ligjeve ashtu edhe zbatimin e tyre. Fakt tjetër me rëndësi është mos parashikimi dhe njoftimi i afateve kohore dhe kjo vlen jo vetëm për institucionet bartëse, por edhe për institucionet tjera, Qeveria dhe Kuvendi, si një praktikë nga e cila dëmtohet performanca dhe efikasiteti i institucioneve. Është për t'u vlerësuar fakti se zyrtarët e institucioneve bartëse, gjatë fazës së hartimit, çdoherë e më shumë po i kushtojnë rëndësi të theksuar substancës së ligjeve, por kjo nga ana e tyre nuk përcillet si duhet me respektimin afateve kohore.

Mos respektimi i afateve kohore bënë që ligjet të vonohen edhe me vite, bie fjala ligji për gjykatat, ligji mbi prokurorinë, këshillin gjyqësor dhe ligji mbi këshillin prokurorial. Këto ligje, të cilat gjenden si veprime që duhet përfunduar qysh në PVPE-në 2006-2008, nxjerrin në dritë një të metë të madhe në zbatimin e PVPE-së, e cila ka të bëjë me mungesën e analizës për veprimet të cilat do të duhej të adresoheshin me urgjence dhe me afate të parapara me më saktësi. Parashikimi i veprimeve të cilat vonohen për muaj të tërë, apo për vite me radhë, nxjerrë disa të meta që kanë të bëjnë me planifikimin dhe me zbatimin, e në disa raste edhe me mungesën e përvojës dhe përgjegjësisë institucionale. Kur jemi te pritjet që kanë të bëjnë me procesin e integritetit, një sfidë tjetër në nxjerrjen e ligjeve në përgjithësi, por edhe ligjeve që monitorojmë duket të jetë mungesa e një praktike ligjbërëse

sipas së cilës do të vlerësohej nevoja për përvetësimin e ndonjë modeli më të veçantë ligjor nga vendet tjera, në rast se një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme për rrethanat dhe infrastrukturën ligjore të Kosovës. Kështu, reflektimi në lidhje me vërejtjet në raportin e progresit për Kosovën duhet të synojnë jo vetëm përmirësimin e fushës por edhe ngritjen e efikasitetit ligjbërës. Defekt tjetër është edhe mos respektimi i afateve të procedimit të projektligjeve nga leximi i parë në leximin e dytë, si dhe vonesat e panevojshme nga ana e qeverisë që të procedojë ligjet në Kuvend sipas strategjisë legjislative të Kuvendit. Kjo nxjerrë në pah një të metë të madhe të institucioneve në lidhje me organizimin e brendshëm të aktiviteteve si dhe koordinimin reciprok mes institucioneve qendrore.

Për ta bërë më të qartë, edhe pse qeveria është zotuar për të përgatitur dhe miratuar 25 projektligje për periudhën janar-mars të këtij viti, në bazë të strategjisë së saj legjislative për 2009, vetëm dymbëdhjetë prej tyre janë miratuar dhe proceduar për në Kuvend për periudhën paraprake. Madje në strategjinë e miratuar nga qeveria figurojnë edhe të tilla ligje që është dashur të miratohen vitin e kaluar, siç është projektligji për punësimin e të huajve në Kosovë. Qeveria arsyetohet me mungesë të bazës buxhetore si dhe për shkak të vëllimit të madh të ligjeve që për të njëjtën kohë po hartohen në grupet punuese. Problem tjetër me rëndësi në hartimin dhe procedimin e ligjeve paraqitet edhe mungesa e stafit brenda ministrive që janë përgjegjës në zyrat ligjore, zyra këto mbi cilat bije barra e hartimit dhe procedimit të ligjeve për në qeveri. Në Ministrinë e Drejtësisë në më pak se dy vjet punën e kanë lëshuar afërsisht 30 të punësuar, dhe kjo sipas tyre ka vështirësuar procesin e hartimit të ligjeve. Ky fenomen nuk është i shprehur vetëm në Ministrinë e Drejtësisë por edhe në dikasteret tjerë të qeverisë dhe kjo kryesisht për shkak të pagave të vogla që kanë të punësuarit në këto institucione. Kjo njëkohësisht nxjerr në pah mungesën e masave motivuese që do të ndikonin në uljen e shkallës së numrit të atyre që lëshojnë punën brenda institucioneve publike të vendit.

Ndryshe, nga ana tjetër konstatim pozitiv është që në të gjitha ligjet e procedura në Kuvend respektohet kriteri i marrjes së pëlqimit të deklaratës financiare nga ana e MEF-it si dhe deklaratës së pajtueshmërisë me parimet e *acquis communautaire* nga Agjencioni për Koordinim të Zhvillimit dhe Integriteteve Evropiane (AKZHIE). Kur jemi tek deklarata e pajtueshmërisë me *acquis communautaire* duhet theksuar se kjo deklaratë vetëm eliminon kundërshtimet që mund të jenë me parimet *acquis* por ajo nuk jep vlerësim për cilësinë dhe efikasitetin e ligjit që nënkupton se ligji nuk është në kundërshtim me standardet evropiane, por ai njëkohësisht mundet të mos përkojë me cilësinë e ligjeve në shtetet e BE-së.

Komisioni për legjislacion pohon se ligjet të cilat vijnë për shqyrtim janë të dobëta dhe shpesh herë janë edhe të pa lexueshme, madje ato vijnë shpesh edhe me gabimeve të shumëta drejtëshkrimore dhe sintaksore.

Ekzistojnë vërejtje të shumta në lidhje me transparencën dhe përvetësimin e praktikave të mira nga ana e institucioneve që zbatojnë PVPE-në. Në procesin e përpilimit të ligjeve shpesh anashkalohen faktor të ndryshëm jashtë institucional, e njëjta gjë vlen edhe për ekspertet. Në disa raste, institucionet nuk janë transparente në këtë drejtim duke ndërmarrë aktivitete për të cilat mungon informacion për audiencën e specializuar, sikurse edhe për publikun më të gjerë. Në këtë mënyrë, institucionet që zbatojnë PVPE-në në procesin e përpilimit të ligjeve përvetësojnë praktika në mënyrën e tyre, pa konsultim paraprak dhe pa ndonjë vizion të qartë që pasqyron nevojat në terren. Me futjen në fuqi të ligjit për qeverinë, qeveria e Kosovës do të ndryshoj në disa sfera të funksionimit të saj, duke i dhënë kryeministrit kompetenca të reja lidhur me qeverinë e që shkojnë deri tek e dreja e krijimit të ministrive të reja pa portofol si dhe reduktimi i zëvnendësministrave në ministritë që nuk mbulojnë një fushë të gjërë.

Element pozitiv dhe që i kontribuon transparencës publike është se mbledhjet e Kuvendit dhe kryesisë çdoherë përcillen me publikimin e procesverbaleve në ueb-faqen e Parlamentit dhe se deputetët i marrin këto procesverbale në kohë reale, mirëpo, janë komisionet parlamentare ato të cilat jo çdoherë bëjnë publikim me kohë të procesverbaleve të cilat ndihmojnë në ngritjen e transparencës publike, madje disa komisione të kuvendit, asnjëherë nuk bëjnë publikimin e procesverbaleve. Mungon një nivel më i përparuar i përdorimit të gjuhës parlamentare nga ana e deputetëve, pa ngjyime ofenduese dhe destruktive. Ky zhvillim, dëmton proceset e integriteteve duke i shtyrë çështjet primare në periferi dhe zëvendësuar ato me aspekte që nuk kontribuojnë procesit të integriteteve. Kuvendi, edhe pse i obliguar të hartojë raporte tre-mujore të shpenzimeve, gjetjet tona tregojnë se deputetët nuk marrin asnjëherë raporte të tilla. Kuvendi sikurse të gjitha institucionet tjera ka për obligim të nxjerrë raporte të rregullta dhe transparente për publik në lidhje me shpenzimet e brendshme si institucion. Deputetët që tani kanë shërbyer në dy mandate të plotë në këtë Kuvend janë shprehur që asnjëherë nuk kanë parë raporte periodike mbi këto shpenzime, përjashtimisht atyre vjetore, ndërsa PVPE parasheh raporte të rregullta tremujore.

Një aspekt tjetër i cili në një shkallë të theksuar dëmton edhe procesin e integriteteve evropiane është mungesa e një administrate publike profesionale. Në këtë drejtim, përfaqësuesit e opozitës, Agjencioni Kundër-korrupsionit si dhe shoqëria civile shprehin brengen e tyre në lidhje me mos funksionimin e Këshillit për Emërime të Larta Publike (KELP), mos funksionim që cilësohet si e qëllimshme dhe me prapavijë politike. Fakti qëndron se në rast se do të kishim funksionim të KELP, emërimet dukshëm do t'i kontribuonin ngritjes së profesionalizmit dhe kompetencës së zyrtarëve të emëruar, duke qenë se ata në përzgjedhje do të dëshmonin cilësi dhe konkurrencë të fortë. KELP-i nuk është mbledhur asnjëherë gjatë këtij viti, mos mbledhja e tij është vlerësuar shkelje e ligjit nga ana e Agjencisë Kundër-korrupsionit dhe zëri për këtë është ngritur edhe nga ana e shoqërisë civile. Shkarkimet dhe emërimet e sekretarëve permanentë në Ministrinë e caktuara në mungesë të KELP-it bëhen nga udhëheqës politikë gjë që dëmton rëndë administratën publike. Kjo vërteton zërat që thonë se konkurset publike nuk e kanë rëndësinë për të cilën shpallen, duke qenë se përzgjedhja e zyrtarëve bëhet mbi baza kryesisht politike.

Kur është fjala të përdorimi i pyetjeve parlamentare si instrument kontrolli demokratik, përfaqësuesit e subjekteve të ndryshme politike në opozitë dallojnë mes tyre, disa prej tyre vlerësojnë se ekziston mungesa e interesit për të përdorur pyetjet parlamentare në mënyrë të duhur dhe cilësore dhe se më tepër përdoren për të bërë shfaqje mediale.

Opozita kritikon mos paraqitjen e rregullt të përfaqësuesve të ekzekutivit në kuvend. Ata shprehen se pjesëmarrja e ministrave dhe e kabinetit qeveritar në mbledhje të Kuvendit është masive vetëm në fillim, por nga mesi pothuajse të gjithë ministrat lëshojnë kuvendin. Ky zhvillim pritët të ndryshojë me agjendën e re të Kuvendit e cila i shërben edhe kabinetit qeveritar për të aranzhuar agjendën e tyre ditore me atë të Kuvendit në mënyrë që pjesëmarrja e tyre të ngritet.

Komisione të caktuara kanë filluar edhe me përgatitjen e planeve për monitorim të zbatimit të ligjeve, si shembull të mirë kemi atë të komisionit për legjislacion. Ky zhvillim pritët të ndihmojë Kuvendin në ngritjen e kapaciteteve në ushtrimin sa më cilësor të funksioneve të tij, jo vetëm në funksion të ligj-bërjes e përfaqësimit, por edhe të mbikëqyrjes. Pavarësisht, deri më sot, nuk ka informacione publike në formë të shkruar apo nga mediat i cili do të bënte publik rezultatet e monitorimit të zbatimit të ligjeve.

Një zhvillim i përgjithshëm i cili ka të bëjë me nxjerrjen e ligjeve është fakti se institucionet kanë filluar që përherë e më shumë të reflektojnë në lidhje me veprimet të cilat dalin si pasojë e kritikave apo rekomandimeve nga raporti i progresit për Kosovë. kjo reflektohet me shtimin e interesimit të deputetëve, ku përherë të parë u thirr në interpelancë për raportin e progresit kryeministri i vendit si dhe shprehja e vullnetit të mirë të Parlamentit përmes miratimit të një rezolute për integritet evropian.

Në anën tjetër ka lëvizje inkurajuese në drejtim të koordinimit dhe zbatimit sa më efikas të ligjeve sikurse është formimi i një mekanizmi ndër-ministral me qëllim të verifikimit të shkallës së zbatimit të ligjeve në vend. Ky mekanizëm mbledhet një herë në muaj në takime të rregullta dhe diskuton për ecurinë e zbatimit të ligjeve dhe pengesat në këtë drejtim dhe po ashtu ofron rekomandimet përkatëse për mënyrën dhe formën e zbatimit të ligjeve në segmente të caktuara. Po ashtu drejtorët e zyrave ligjore obligohen që të dërgojnë raporte mujore te zyra ligjore e Kryeministrit, raporte të cilat përmbajnë konstatime për shkallën e zbatimit të ligjeve dhe mangësive apo defekteve që paraqiten.

INTEGRIMI EVROPIAN DHE KOORDINIMI NDERINSTITUCIONAL

Agjencioni për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritet Evropian (AKZHE) i cili funksionon në kudër të qeverisë së Kosovës dhe i cili i përgjigjet direkt Kryeministrit të Kosovës, paraqet mekanizmin qendror koordinues në procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Çdo zhvillim i cili i takon sferës së integritetit të Kosovës në BE iniciohet ose kalon përmes këtij agjencioni. Ndër përgjegjësitë e shumta që ky agjencion ka, veçohen hartimi dhe rifreskimi i përvjelshim i PVPE-së i cili është ndër dokumentet kyçe në këtë proces, pastaj koordinimi i mjeteve të zotuar nga Konferenca e Donatorëve për Kosovën si dhe koordinimi i Instrumentit për paraanëtarësim (IPA). Rëndësia dhe roli i AKZHE-së në këtë proces është i pakontestueshëm, mirëpo funksionimi i mirëfilltë i tij është duke lënguar qysh nga krijimi i tij. Së pari, baza juridike e këtij agjencioni akoma nuk është koherente pasi agjencioni punon me rregulloren e UNMIK-ut edhe pse Kosova është e pavarur tashmë një vjet e gjysmë. Qeveria me vendimin e saj 09/41 vetëm sa ka ndryshuar emrin e agjencionit, por jo edhe bazën e veprimit të tij. Së dyti, agjencioni në vazhdimësi përballet me fenomenin e ndërrimit të ushtrueseve të detyrës së Kryeshefit si dhe me fenomenin e lëshimit të punës nga ana e zyrtarëve të këtij agjencioni dhe së fundi, është problemi i

mungesës së hapësirës së mjaftueshme të punës e cila pengon dhe pamundëson zhvillimin e mëtutjeshëm të agjencionit.

Komisioni Evropian qoftë përmes Raportit të Progresit apo edhe përmes zyrtarëve të tij në zyrën ndërlidhëse në Prishtinë vazhdimisht kërkojnë që të zgjidhet problemi i lëshimit të punës nga ana e zyrtarëve si dhe problemi i ndërrimit të u.d. kryeshefave, duke u shprehur se në proces të funksionimit, këtij agjencioni i ka munguar dhe i mungon udhëheqja strategjike dhe vizionare si dhe sensi i përgjegjësisë.

Koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të PVPE-së janë përgjegjësi e agjencionit, mirëpo në këtë drejtim mungon një praktike e avancuar për monitorim të vazhdueshëm të progresit. Prezenca e zyrave për integritet evropian pothuajse në secilën ministri është për tu vlerësuar, pasi që roli i tyre është i jashtëzakonshëm dhe i pazavendësueshëm në koordinimin e procesit dhe përshpejtimin e tij, mirëpo në këtë drejtim duhet theksuar se këto zyre mungojnë në disa institucione të rëndësishme siç janë Banka Qendrore, Agjencioni Kundërkorrupsion si dhe në gjyqësor. Këto zyra mbi bazën e Planit për Integritet 2008 - 2010 të hartuar dhe aprovuar nga qeveria janë të obliguara që të hartojnë raporte mbi baza një muje, tre muje dhe nëse kërkohej edhe mbi baza javore. Kualiteti i raportimit në përgjithësi nga agjencioni vlerësohet si i kënaqshëm por jo i mjaftueshëm. Monitorimi më i rregullt i progresit do të ndihmonte edhe në përmirësimin e vlersimit të përgjithshëm apo vlersimeve më specifike nga ana e qeverisë në lidhje me arritjen e objektivave të vendosura.

Si duket, evidentimi i dështimeve nuk është interes i qeverisë. Për pasojë, proceset integruuese mbeten vetëm nën dritën e vlersimit të Komisionit Evropian në raportin e progresit dhe akterve jo-qeveritar në Kosovë. Një koncept më i avancuar i qeverisjes do të ndryshonte këtë zhvillim duke u interesuar edhe për sfidat apo dështimet nga ana e institucioneve përgjegjëse. Vlersimi real i brendshëm i procesit të integritetit do të ndikonte në rritjen e efikasitetit. Dokumenti "input për raportin e progresit" i nxjerrë nga agjencioni në baza 6 muje evidenton vetëm të arriturat në zbatimin e PVPE-së, por asnjëherë dështimet.

Një fakt shqetësues është edhe moskonsultimi i shoqërisë civile dhe akterve tjerë për të kontribuar në përmirësimin e PVPE-së. Modeli i qeverisjes së demonstruar nga qeveria po lë në hije rëndësinë e sektorit jo-qeveritar në Kosovë duke e përjashtuar prezencën dhe kontributin e saj në dokumente dhe ngjarje kyqe, një gjë e tillë po ndodhë edhe me hartimin dhe rifreskimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian ku nuk është

ftuar asnjë pjesëtar i shoqërisë civile qoftë edhe në rolin e vëzhguesit. Veprime të tilla dëmtojnë transparencën e institucioneve dhe bashkëpunimin në tërësi. Është me rëndësi të theksohet se edhe përkundër ekzistimit të një plani për komunikim të jashtëm, agjencioni vazhdon të mos jetë aktiv në opinionin publik. Kjo vërtetohet me mungesën e një zyrtari për media në këtë agjencion.

Në shtyrjen përpara të procesit të integriteteve, vonesa të shpeshta shkaktohen për shkak të numrit të madh të veprimeve jo mirë të planifikuara brenda PVPE-së. Ky numër i ngarkon zyrtarët në ministri të ndryshme me punë të cilat nuk mund të përballohen. Mirëpo zyrtarët për integritet evropian shpeshherë ngarkohen edhe me përgjegjësi të cilat i tejkalojnë termat e referencës së punës së tyre. Prandaj, pavarësisht angazhimeve që veprimet të realizohen brenda afateve ato shpesh nuk përmbushen me kohë.

Një sfidë e cila po dëmton të gjitha aspektet e mirë-funksionimit të institucioneve është ikja e stafit apo zyrtarëve të ngarkuar me integritet evropiane dhe PVPE, duke lënë pas zbrazëti në lidhje me përvojën, komunikimin, orientimin apo dhe frymën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme. Largimi i shumë zyrtarëve për integritet evropiane brenda AKZHIE, dhe ministrive bartëse të ligjeve cenon të gjitha aspektet e lartpërmendura. Koordinimi mes AZHKIE dhe ministrive të linjës shpesh dëmtohet për shkak se stafi i nivelit më të lartë brenda këtyre ministrive nuk i përgjigjet AZHKIE-së në ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për procesin e integriteteve. Ngjashëm mund të vlerësohet edhe përfshirja jo shumë aktive e zyrtarëve të ngarkuar me integritet evropiane në ministrinë e linjës nga ana e AZHKIE-së edhe pse e fundit bënë përpjekje serioze në këtë drejtim. Duhet theksuar se në termat e referencës së këtyre zyrtarëve është edhe shtyrja përpara e përmbushjes së veprimeve që i takojnë ministrisë përkatëse me PVPE, mirëpo roli i zyrtarëve në këtë drejtim është minimal për të mos thënë se nuk ekziston fare. Pastaj koordinimi i zyrtarëve mes vete është një problem tjetër. Zyrtarët takohen vetëm në rishikimin e PVPE-së por nuk kanë takime tjera për të koordinuar veprimet ndërministrorë dhe për të shqyrtuar prioritetet.

Duke qenë se procesi i koordinimit, tërheq me vete edhe aspektin e përgjegjësisë në lidhje me performancën e zyrtarëve, një zhvillim shqetësues është fakti se veprime që lidhen me integritet evropiane, më saktësisht me PVPE, jo gjithmonë marrin përkushtimin dhe interesin e duhur, kjo sepse këto veprime nuk janë në plan të parë, duke mos qenë prioritet për institucionet dhe zyrtarët e angazhuar në këtë proces.

Kështu, koordinimi i zyrtarëve për integritet nga ministritë e linjës kundrejt AKZHIE shpesh mbetet një proces i cili kryesisht bazohet në vullnetin e mirë të zyrtarëve dhe jo i agjendës së institucionit të tyre, dhe kjo ndodh pavarësisht faktit se proceset që lidhen me integritet dhe veprimet në PVPE formalisht deklarohen si agjendë e pandashme e të gjitha institucioneve.

Siç vihet re, zyrtaret për integritet në ministritë e linjës nuk e vlerësojnë sa duhet nivelin e dhënies së përgjegjësisë në lidhje me angazhimin e tyre. Në këtë kontekst, përgjegjësia në lidhje me performancën e zyrtarëve në ministritë e linjës por edhe atyre brenda AKZHIE, do të mund të përmirësohej duke u ngritur niveli i llogaridhënies në nivel më të lartë të qeverisë, thënë më saktësisht, organizimit më konsistent të punës në nivel sekretarësh dhe krye-shefit të AKZHIE-së, apo kur është e nevojshme edhe në nivel më të lartë të hierarkisë qeveritare. Ndoshta do të duhej shikuar që pas hyrjes në fuqi të ligjit për qeverinë, njëra nga ministritë pa portofol të jetë për integritet evropiane dhe në këtë mënyrë do të shprehej qartë përkushtimi i qeverisë por do të zgjidheshin shumë probleme të vendimmarrjes dhe të adresimit të përgjegjësisë për procesin.

Kështu siç është gjendja, ministritë e linjës së bashku me AKZHIE do të duhej të përfshiheshin më shumë në aktivitete të përbashkëta dhe të koordinuara që lidhen me raportin e progresit, konkretisht prioritetet që dalin nga ky raport, analizimin e vështirësive në procesin e zbatimit të PVPE-së, sistemin e ndarjes së informatave në kohë dhe mënyrë pro-aktive, por edhe raportimin dhe përgjegjësinë në lidhje me lëshimet apo dështime si dhe në nxjerrjen e mësimëve.

Aktualisht, koordinimi i aktiviteteve të sapo-përmendura mbetet shumë i dobët, ndërsa planifikimi dhe përgjegjësia mbeten në nivel të izoluar brenda ministrive apo AKZHIE-së. Në këtë drejtim, mungon sistemi i ndarjes dhe delegimit të aktiviteteve, dhe hera herës, bëhen aktivitete të dis-koordinuara. Nga sa është venë re, këto zhvillime ndodhin për shkak të mungesës së njohurive, mungesës së konceptimit të procesit, apo edhe mungesës së një logjike më të përparuar institucionale në lidhje me organizimin e aktiviteteve. Procesi i konsultimit ndër-institucional mbetet kryesisht, një proces një-kahor, nga AKZHIE kundrejt ministrive dhe institucioneve tjera.

Një zhvillim tejet shqetësues është edhe neglizhimi i kuvendit të Kosovës në procesin e integritimeve nga ana e ekzekutivit., kjo shpjegohet me ikjen e debatit mbi PVPE-në në Kuvendin e Kosovës edhe pse vetë plani për integrim 2008-2010 parasheh një gjë të tillë, pastaj mos dërgimi i raporteve të shkruara nga ana e zëvendës kryeministrit përgjegjës për integritime evropiane në Komisionin për Integritime Evropiane në Parlament si dhe mungesa e komunikimit reciprok. Mirëpo defekti në këtë drejtim duket të jetë edhe tek vetë Komisioni për Integritime Evropiane në Kuvend i cili ndonëse përballet me vështirësi të lidhura me funksionimin më të mirëfilltë apo edhe mungesë të madhe të përkrahjes dhe ekspertizës së jashtme, nuk duket të ketë ushtruar rolin mbikëqyrës, duke u mbyllur më shumë në aktivitete të përditshme në Kuvend.

Komisioni në fjalë, së fundi ka përpiluar një plan veprimi i emëruar si Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008 (*shpjegim: pavarësisht përmbajtjes së këtij dokumenti, do të duhej evituar emërtimin e njëjtë me dokumentin gjithëpërfshirës i njohur që disa vite si PVPE të përmendur më lartë*) dhe po ashtu, i hartuar në të njëjtën formë dhe metodologji. Ky dokument i brendshëm i Kuvendit i hartuar së voni, ndonëse pozitiv për nga aspekti i marrjes me më seriozitet vërejtjet e përmendura në raportin e progresit në lidhje me punën e kuvendit, duket se ka qene krejtësisht i panevojshëm, sepse me të dublohet një dokument si PVPE e hartuar në nivel kombëtar. Këto vërejtje do të mund të ishin adresuar nga vet kuvendi në dokumentin strategjik për përmirësimin e punës, apo edhe mund të jenë përfshirë në kuadër të PVPE së ekzekutivit. Huazimi i terminologjisë së njëjtë për dokumente të rëndësishme kombëtare apo edhe duplikimi i aktiviteteve planifikuese për të njëjtat objektiva, ndikon në krijimin e konfuzionit si dhe dëmton bashkëpunimin më të mirë ndër-institucional. Njëherësh, kjo tregon se deputetet brenda këtij komisioni nuk e kanë kuptuar sa duhet rëndësinë e dokumenteve strategjike dhe përfshirjen e prioriteteve të kuvendit brenda tyre, ose faktin se ata nuk kanë dijeni për zhvillimet institucionale në nivel të ekzekutivit, duke nxjerrë kështu punë të pa nevojshme në harmonizimin e këtyre dy dokumenteve në të ardhmen.

Kështu, mund të thuhet se më gjithë vullnetin e mirë në lidhje me nevojën dhe aktin e themelimit, këtij komisioni i kanë munguar njohuritë që kanë të bëjnë më njohjen më të mirë të procesit të integritimeve dhe pranimin e orientimeve të përgjithshme strategjike që dalin nga ky proces. Aktualisht, ky komision rolin mbikëqyrës është interesuar ta ushtrojë më shumë në raport me nivelin më të lartë institucional, sikurse adresimin e shqetësimeve

tek ministrat por kjo nuk do të duhej të kufizohej vetëm në këtë nivel. Deputet e opozitës brenda këtij komisioni kanë shprehur shqetësimin se ka pasur raste kur ministrat nuk kanë kthyer përgjigjeje në lidhje me shqetësimet që ka paraqitur komisioni për integritet brenda kuvendit. *(këtu vlen të përmendet rasti i ministrit të MEF-it Ahmet Shala dhe ministres së Ministrisë së Drejtësisë Nekibe Kelmendi)* Niveli i organizimit të seancave për procesin e integritetit brenda kuvendit të Kosovës nuk duket se përkon si duhet me rëndësinë që paraqet agjenda për integritet. Kjo ka të bëjë si me përmbajtjen sipërfaqësore, ashtu edhe me kohën e shkurtë diskutimit në këto seanca.

Një zhvillim pozitiv për tu përmendur është fakti se AZHKIE ka filluar që të përfshijë strukturat lokale në sensibilizimin e opinionit publik për rëndësinë e procesit të integritetit evropian. Një shembull për tu përmendur është bashkëpunimi në këtë drejtim me komunën e Prishtinës. Takimet me komunitete lokale ndihmojnë dukshëm agjendën për integritet sikurse edhe që i kontribuojnë ngritjes së përkushtimit politik dhe institucional.

KOMUNIKIMI (Thembra Akilit)

AKZHIE ndonëse përcjellë punën e komisionit për integritet në kuvend ka mbetur shkëputur dhe në distancë për sa i përket koordinimit të bashkëpunimit të aktiviteteve, duke u treguar institucion i brishtë për faktin se zyrtarët e këtij institucioni mund ta gjejnë vetën në një pozicion të vështirë në balancimin e marrëdhënieve kundrejt qeverisë nga e cila drejtohet dhe komisionit me të cilin pritet të thellojë bashkëpunimin. Për pasojë, institucioni mbanë një qasje jo aktive kur është fjala të shtyj çështjet për integritet evropian në bashkëpunim me komisionin për integritet. Si shembull, zyrtarët e këtij institucioni kishin punuar në përgatitjen e draftit të rezolutës e cila ishte aprovuar nga kuvendi, por ata nuk janë në dijeni se në çfarë forme i ka kaluar në dorë ky dokument komisionit, sepse AKZHIE nuk kishte dërguar ndonjë draft. Në të dyja rastet, me nxjerrjen e PVPE-së si dhe rezolutës për integritet, komisioni as nuk ka informuar as konsultuar AKZHIE-në. I fundit nxjerrjen e PVPE-së e konsideron më shumë si një strategji legislative afatizuse.

Një dukuri e cila mund të dëmtojë koordinimin ndër-institucional përveç delegimit dhe ndarjes së aktiviteteve është edhe standardizimi i emërimit të zyrave dhe pozicioneve zyrtare brenda ministrive të linjës, proces i cili lidhet me planifikimin e nevojave në lidhje

me burimet njerëzore, emërtimin e zyrave apo njësive për integrim, duke shmangur kështu emërtimet e ndryshme për institucione të përfshira në të njëjtin proces.

Për dallim nga AKZHIE e cila e ka për mandat të komunikoj rregullisht me institucionet tjera, përkatësisht me stafin e angazhuar në punën që ka të bëjë me integritet evropiane, një gjë e tillë nuk ndodh me komisionin parlamentar i cili duket se fare nuk është i përfshirë në procesin e njohjes apo monitorimit të drejtpërdrejt të punës në ministritë e linjës, edhe për kundër faktit që kjo përmendet në mesin e përgjegjësive të tyre.

Ndryshe sipas AKZHIE, një defekt i dukshëm në zyrat për integritet në ministri është mungesa e një standardi i cili do të harmonizonte planifikimin dhe raportimin në lidhje me aktivitetet që lidhen me PVPE. Disa organizojnë punën sipas planeve, disa sipas strategjive, disa ad-hoc. Gjithashtu, një problem tjetër i nënvizuar nga ky institucion është se zyrtarët për integritet nëpër ministri kanë detyra shtesë të cilat pengojnë aktivitetin e tyre themelor - integritet evropiane. Pavarësisht këtij fakti, zyrat për integritet në këto ministri raportojnë rregullisht progresin, mbi bazën tremujore, por është për t'u kritikuar mungesa e nivelit më të lartë të bashkëpunimit, sidomos tek disa sekretarë permanent të ministrive të cilët nuk marrin pjesë në takime të lidhura me harmonizimin dhe finalizimin e PVPE-së. AKZHIE dhe ministritë e linjës janë përgjegjës kryesor për mos finalizimin e këtij dokumenti brenda afateve, duke e vonuar për muaj me radhë. Pavarësisht shkaqeve, mos finalizimi në kohë i këtij dokumenti dëmton procesin në të gjitha aspektet, sepse shkakton konfuzion institucional dhe publik, shpenzon energji, si dhe dëmton efikasitetin e institucioneve.

Ndryshe për sa i përket kapaciteteve njerëzore, duhet përmendur se AKZHIE ka punësuar staf të ri të dalë nga skema e bursistëve që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të institucioneve për integritet dhe procese tjera në përgjithësi. Ky institucion ka nevojë për më shumë staf. Duke qenë se volumi i punëve dhe kërkesat që dalin nga procesi i integritet evropiane sa vijnë e shtohen, paraqitet nevojë e pashmangshme për punësimin e stafit të ri dhe të përgatitur në këtë fushë. Njëkohësisht kjo duhet të përcillet me motivimin e stafit në mënyrë që stafi të mos praktikoj largimin nga AKZHIE dhe ministritë duke dëmtuar kështu potencialin dhe angazhimin e institucionit. Pakënaqësitë e agjencionit nuk janë shqyrtuar nga qeveria duke u munduar që problemin ta zgjidhin përmes heshtjes së tij, kjo ilustron me faktin se në muajin Janar 2009 pothuajse i gjithë stafi ishte futur në grevë për shkak të pakënaqësive që lidheshin me pagat dhe procesin në përgjithësi.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës shprehin shqetësimin se Kuvendit i mungon përkrahje nga ana e eksperteve me përvojë. Për pasojë shumë ligje të përgatitura në mungesë të ekspertizës nuk përkojnë me natyrën e problemeve të cilat synojnë t'i zgjidhin, dhe kjo për faktin se në procesin e përpilimit, shumë prej këtyre ligjeve vetëm përkthehen duke mos u analizuar paraprakisht. Një staf më i madh në numër dhe më i përgatitur profesionalisht do të ndihmonte në fuqizimin e efikasitetit në zbatimin e PVPE-së nga ekzekutivi. Mungesa e stafit ndikon edhe në mbingarkesën e stafit aktual duke dëmtuar fokusin që rezulton me mos përmbyllje të prioritetëve që dalin nga PVPE. Kur jemi te ekspertët duhet cekur që ministrinë dhe departamentet e veçanta brenda këtyre ministrive nuk kanë buxhet për t'i financuar ekspertët që i ftojnë. Shembull; rasti i miratimit të katër ligjeve të gjyqësorit (*ligji për Gjykatat, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor dhe Prokuroritë*). Për këto ligje zyra ligjore ka ftuar ekspertët, mirëpo për shkaqe të mos mbulimit financiar të kontributit të tyre ata braktisin grupet punuese.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm duke qenë se respektohet, është marrja e pajtueshmërisë apo deklaratës financiare nga ministria e financave në lidhje me implikimet buxhetore, apo nga AKZHIE për koordinim dhe zhvillim për integritet evropian në lidhje me pajtueshmërinë me *acquis communautaire*. Por, duket që kjo deklaratë dhe pajtueshmëri nuk përkon me nevojën për analizimin e hollësishëm të ndikimit të përgjithshëm dhe ndryshimin e gjendjes në terren. Në këtë proces mungon një interesim që të studiohet më mirë impakti buxhetor i ligjeve që nxirren, zhvillim i cili do të kërkonte konsultim ndër-institucional mes bartësit, ministrisë së ekonomisë dhe financave si dhe faktorëve me interes.

Në një pikë tjetër, marrëdhëniet mes AZHKIE dhe Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë janë shumë të ndëvarura. Por, AZHKIE jo gjithmonë gjenë mënyren dhe qasjen e duhur në komunikim me Zyrën e KE, duke mos qenë në nivel sidomos kur është fjala për konsultim në lidhje me procesin integruar, komunikim informacionesh, raportim të progresit apo vështirësive, si dhe në lidhje me qështje tjera me më shumë apo më pak rëndësi. Një iniciativë e përbashkët e vullnetit të mirë, e cila do të synonte përmirësimin e komunikimit dhe konsultimit mes zyrës së KE dhe AZHKIE, duke e ndihmuar këtë të fundit në përmirësim të qasjes do të përmironte nivelin e komunikimit mes tyre.

Për momentin, në këto rrethana, zyrtarët e AZHKIE janë në një pozitë konfuze kur është fjala për marrëdhëniet e tyre të komunikimit dhe konsultimit me Zyrën e KE, duke mos përvetsuar një komunikim më të mirëfilltë dhe të organizuar. Madje vetë zyrtarët e AZHKIE mes tyre, shpesh dhe panevojshëm paraqiten si konkurrues dhe duplikues duke qenë së i komunikojnë Zyrës së KE informacione të së njëjtës natyrë, duke u përceptuar si të pa organizuar apo si zyrtarë që ndjekin agjenda personale pavarisht se shërbejnë në një institucion qeveritar. Mos përceptimi i duhur i punës dhe kompetencave të agjencionit bënë që shpesh të dërgohen dokumente interne për konsultim në Komisionin Evropian, kurse vetë Komisioni ka refuzuar që të japë inpute dhe komente për PVPE-në 2009 duke lënë të kuptohet se përgjegjësia është tek ekzekutivi i pavarur i Kosovës.

Harmoizimi i ligjeve me *acquis communautaire* mbetet ende një sfidë e cila ishte raportuar në raportin e progresit 2008, ndërsa nuk janë marrë hapa në përmirësim të kësaj gjendje. Përkthimi i *acquis* ka ngecur si rezultat i mungesës së një memorandumit bashkpunimi me Shqipëri të paraparë të nënshkruhet në Prill 2009. Komunikimi me publik i AZHKIE-së gjithashtu duket të jetë i pa organizuar si pasojë e mungesës së zyrtarit përgjegjës, pavarisht faktit se procesi i integritimeve ka nevojë t'i komunikohet publikut në vazhdimësi.

Probleme tjera që e definojnë qartë rolin e ri dhe më të fuqishëm që duhet të ketë ky institucion lidhen gjithashtu edhe me mungesën e një vendimi të ri qeveritar i cili do të ndryshonte rregulloren e vjetër të UNMIK-ut sipas të cilës ende funksionon ky institucion. Organogrami pastaj do të ndërtohej mbi këtë vendim dhe jo siç është ndërtuar tani pa ndonjë bazë të mirëfillte ligjore. Këto paraqesin disa lëshime nga ana e qeverisë në këtë drejtim, edhe pas ndërrimit të emrit të këtij institucioni nga Agjencioni për Integritime Evropiane në AZHKIE.

Këto zhvillime duket se arsyetojnë zërat se AZHKIE-së i mungon një strategji dhe udhëhqqe më e strukturuar duke u karakterizuar nga veprimet ad-hoc. Zëra të tillë shkojnë edhe më larg duke konsideruar se kjo mund të jetë pasojë e ndërrimeve të shpeshta por edhe të mungesës së përvojës së disa nga drejtuesve që prej se kur është themeluar ky institucion.

Sfidat dhe Rekomandimet:

Sfidë: Sfidë afatgjatë e cila po përcjellë proceset e integritimeve evropiane është fakti se ky është një proces gjithëpërfshirës i cili implikon nevojën për ndërmarrjen e veprimeve në të gjitha nivelet nga të gjithë akteret vendor.

Rekomandim: Në përfundimin dhe përshpejtimin e progresit të këtij procesi gjithëpërfshirës, institucionet në përgjithësi, e veçanërisht ato qendrore duhet që të sigurojnë që të ketë vullnet të nevojshëm politik e institucional për ndërmarrjen e veprimeve, duke ruajtur përqendrimin dhe përkushtimin për nevojat në terren.

Sfidë: Një sfidë tjetër është numri i shumtë i veprimeve të parapara në PVPE, veprime të cilat jo gjithmonë përkrijnë me mundësitë për t'u realizuar.

Rekomandim: Në përgatitje të këtij dokumenti, institucionet duhet të sigurohen që të parashohin vetëm ato veprime që konsiderojnë se mund të realizohen, duke shmangur planifikimin e veprimeve të pa realizueshme.

Sfidë: Procesi i integritimeve evropiane është një proces i cili kërkon bashkimin e njohurive dhe energjive të palëve të ndryshme në institucione dhe në shoqëri.

Rekomandim: Përfshirja në proces e të gjithë akterëve që mund të kontribuojnë cilësisht, përforcon agjendën evropiane në Kosovë. Kjo vlen për të gjitha veprimet e planifikuara në PVPE, të cilat institucionet i ndërmarrin veçmas apo në partneritet. Mes tjerash, politikat, ligjet, koordinimi, duhet të krijohen në frymë të përfshirjes.

Sfidë: Procesi i integritimeve evropiane në Kosovë nuk është një proces në të cilin subjektet politike bashkëpunojnë dhe kjo dëmton edhe cilësinë dhe vazhdimësinë e punës institucionale ku ato përfaqësohen.

Rekomandim: Subjektet politike duhet të angazhohen në ndryshimin e kësaj gjendje jo bashkëpunimi. Forcave në pozitë në këtë dhe mandatet tjera, ju takon që pa rezerva t'i prijnë ndryshimit të kësaj gjendje.

Sfidë: Planifikimi, koordinimi dhe informimi ndër-institucional por edhe në raport me publikun mbetet fillestar

Rekomandim: Institucionet duhet të marrin me më seriozitet nevojën për përmirësim të këtyre aspekteve. Planet Strategjike do të ndihmonin shumë në këtë drejtim, por mbi të gjitha duhet vullnet politik dhe institucional

Sfidë: Bashkëpunimi në proces i Legjislativit dhe Ekzekutivit mbetet jo shumë i përparuar dhe i vazhdueshëm.

Rekomandim: Këto dy institucione duhet që në një afat sa më të shkurtë të angazhohen në krijimin e praktikave dhe formave të bashkëpunimit, në mënyrë që të ushtrohet roli i tyre institucional por edhe të përmirësohet procesi.

Sfidë: Ikja e stafit të institucioneve është një sfidë e veçantë.

Rekomandim: Nevoja për motivimin dhe përforsim të kapaciteteve të këtij stafi do të duhej adresuar me synim krijimin e kapaciteteve të domosdoshme për të ardhmen, në të kundërtën, procesi i integriteteve dëmtohet në vazhdimësi.

Sfidë: Bërja e procesit të integriteteve dhe veprimeve të lidhura me të, një prioritet si për zyrtaret e nivelit të lartë ashtu edhe për zyrtaret e tjerë, është një sfidë në këtë periudhë.

Rekomandim: Ndërmarrja e vendimeve por edhe masave tjera institucionale që do të përmirësonin nivelin e përgjegjësisë duhet parë si nevojë për tu adresuar nga qeveria e Kosovës.

Sfidë: Kuvendi i Kosovës mbetet jo shumë i informuar dhe angazhuar në lidhje me agjendën për integritet evropian dhe veprimeve që rrjedhin nga kjo agjendë.

Rekomandim: Kuvendi ka nevojë për staf përkrahës i cili do të ndihmonte përfaqësuesit e zgjedhur që të jenë në hap me zhvillimet.

Sfidë: AKZHIE duhet të veprojë me më shumë vendosmëri dhe energji në marrëdhënie me institucionet tjera.

Rekomandim: Një gjë e tillë kërkon përfshirjen me të drejtpërdrejt të nivelit të lartë qeveritar duke fuqizuar dhe përkrahur këtë institucion, dhe jo ta lërë në një pozicion pak a shumë konsultativ në marrëdhënie me këto institucione.

Sfidë: AKZHIE po has në paqartësi në komunikim me Zyrën e Komisionit Evropian.

Rekomandim: Krye-shafi i këtij institucioni duhet që të angazhohet në ndërtimin e praktikave më të përparuara në këtë komunikim

PERFUNDIM:

Agjenda e integrimi evropiane për Kosovë është një proces kompleks dhe i vështirë. Vështirësi të shumta politike, institucionale, të kapaciteteve dhe teknike përcjellin zbatuesit e kësaj agjende në Kosovë. Gjendja e të arriturave të Kosovës mbetet e pa favorshme në krahasim me pritjet e mëdha si vend dhe si shoqëri. Raporti i fundit i progresit për Kosovë i vendos bartësit e këtij procesi në një pozicion ku ata duhet të bëjnë dukshëm më shumë se sa është duke u bërë aktualisht. Një gjë e tillë vlen edhe për pjesën e kritereve politike të përfshira në Planin e Veprimit për Partneritet Evropian. Veprimet e planifikuara në këtë dokument po hasin shumë pengesa në zbatim. Njëherësh kjo po tregon se kapacitetet e Kosovës janë shumë të kufizuara ndërsa vazhdimësia në përcjellje dhe shtyerje përpara të proceseve integruese mbetet e brishtë.

Shtrohet nevoja urgjente për përmirësim të planifikimit dhe sigurim të zbatimit cilësor të veprimeve të parapara, në të kundërtën agjenda evropiane e Kosovës mund të konsiderohet si e pasigurt. Kuptohet se me anë të një monitorimi nuk mund të nxirren përfundime të pa diskutshme, por përgjithësisht mund të vlersohet se të arriturat janë të mangta. Në këtë kontekst, gjetjet në këtë raport pritet t'i shërbejnë institucioneve dhe organizatave tjera në punën që bëjnë, si dhe të nxisë mediat që të angazhohen më seriozisht në mbulim të kësaj agjende në Kosovë. Në rast se seriozisht synohet fuqizimi i rëndsisë dhe të arriturave në lidhje me këtë proces atëhere bashkpunimi mes subjekteve dhe institucioneve është i rëndsisë primare, diçka që nuk nodh aktualisht. Ky bashkpunim duhet të synojë adresimin e çështjeve në lidhje me proceset politike, të ligjbërjës, respektimit të standareve të vendosura, zbatimit të ligjeve, kooordinimit, etj. Nëpërmes një orientimi të tillë do të arriheshin edhe objektiva të brendshme dhe ndër-institucionale, si dhe do të përmirësohej efikasiteti në veprim. Performanca më e mirë e institucioneve, sidomos ekzekutivit dhe legjislativit është me rëndësi primare në këtë drejtim. Gjithashtu, një një ambient demokratik institucionet kufizojnë dhe balansojnë pushtetin mes tyre, ndërsa nga sa vlerësohet nga monitorimi një zhvillim i tillë nuk është shumë i avancuar në marrëdhëniet mes instituconeve në Kosovë. Institucionet nuk janë të përfshira sa duhet në vlersimin real dhe të vazhdueshëm të progresit, duke mos treguar interesimin e duhur për nxjerrjen e mësimave dhe përmirësim. Komunikimi i të arriturave për opinion më të përparuar por edhe për publikun e gjërë është themelor për përparimin e agjendës evropiane në Kosovë. Kur është fjala për stafin e angazhuar të administratës publike, ekziston një nevojë e madhe për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe përfshirjes së tyre, duke i dhënë prioritet veprimeve që dalin nga PVPE, dhe

jo sikur ndodh aktualisht që këtyre veprimeve të mos i kushtohet vëmendje e duhur për nga rëndësia që kanë. AKZHIE është duke hasur në sfida të shumta për fuqizim të agjendës evropiane në Kosovë, si dhe në organizimin e marrëdhënieve me të gjitha palët e përfshira, duke mos përjashtuar edhe interferimet politike e partiake në proces. Menaxhimi më i mirë e procesit bie në fushëveprimtari të këtij institucioni, ndërsa në rast se synohet nxjerrje e rezultateve më të avancuara, atëhere ky institucon duhet të fuqizohet për nga mandati, kompetencat dhe orientimi dhe të lihet të veprojë lirshëm dhe në mënyrë profesionale. Shoqëria civile dhe ekspertë të fushës, kur është fjala të kriteret politike mbeten të anashkaluara. Gjithashtu nevojitet që institucionet të angazhohen në identifikimin e sfidave dhe gjetjen e zgjidhjeve për probleme të ndishme të përmendura në këtë raport.

FAKTE TË SHPEJTA

- ❖ PVPE është shkurtësë për Planin e Veprimit për Partneritet Evropian. PVPE është dokumenti kryesor strategjik i qeverisë së Kosovës për të përmbushur objektivat e parapara me Partneritetin Evropian për Kosovën si dhe kërkesat e vazhdueshme të Bashkimit Evropian që vijnë përmes raportit të progresit dhe dokumenteve tjera, e që si tërësi janë pjesë e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit (MPSA) për Kosovën. PVPE përmban afërsisht 1600 veprime të cilat duhet të përmbushen nga institucionet e Kosovës dhe këto veprime përfshijnë të gjithë territorin e Kosovës.
- ❖ AKZHIIE-së akoma i mungon një bazë ligjore e mirëfilltë për funksionimin e saj dhe si pasojë akoma punon me rregullore të UNMIK-ut.
- ❖ I paraparë të aprovohet më së largu në Prill të çdo viti, PVPE zakonisht vonohet me muaj. Tani jemi në Korrik 2009 dhe PVPE akoma nuk është aprovuar nga qeveria.
- ❖ PVPE freskohet çdo vit me veprime të reja dhe hiqen veprimet e përfunduara. Edhe përkundër faktit se shoqëria civile është shprehur e gatshme që të ndihmojë procesin e integritimeve evropiane për Kosovën, prapëseprapë asnjë pjesëtarë i shoqërisë civile nuk ftohet në freskimin e PVPE-së.
- ❖ PVPE sipas Planit për Integritim 2008 – 2010 duhet të pajtohet në Parlament, mirëpo prejse është nxjerrë PVPE e parë asnjëherë ky dokument nuk është diskutuar në Parlament
- ❖ Komisioni Evropian në takimet e MPSA rekomandon se PVPE është jo realiste dhe tejet ambicioze duke paraparë veprime pa linja buxhetore dhe duke paraparë veprime të paarritshme.
- ❖ Agjencioni për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritime Evropiane (AKZHIIE) parqet mekanizmin qendror Koordinues në procesin e integritimit të Kosovës në BE. Edhe përkundër arritjeve dhe punës së vazhdueshme, agjencioni është shoqëruar me sfida të cilat kanë pamundësuar zhvillimin normal të tij. Pamundësia për të zgjedhur një kryeshef i cili do të ushtronte detyrën në mënyrë profesionale dhe pa inicialet u.d.

(ushtrues detyre) para ka penguar zhvillimin e tij. Ndërrimi i shpeshtë u.d. kryehsefave ka shkaktuar probleme serioze në koordinimin e procesit dhe në arritjen e objektivave të parapara.

- ❖ AKZHIE-ja ka vetëm 32 të zyrtarë, përderisa në Planin për Integrim 2008-2010 parashihet që ky agjencion deri në vitin 2010 të ketë 85 të punësuar.
- ❖ Hapësira ku vepron AKZHIE-ja është e pamjaftueshme për të punuar një staf prej me shumë se 30 personave. Afërsisht 35 veta punojnë në një hapësirë prej mbi 40m²
- ❖ Edhe pse me Planin për Integrim 2008-2010, AKZHIE nxjerrë raporte mbi zbatimin e PVPE-së në baza mujore, tremujore dhe gjashtë mujore, vetëm raportet 6 mujore janë të hapura për publik.
- ❖ Raporti Progresit ka rekomanduar që numri që kontrollon legjislacionin vendor me ato të acquis të rritet, mirëpo në vend të rritjes ky numër është rënë nga 4 në 3. Vetëm brenda dy viteve të fundit punën në AKZHIE e kanë lëshuar 7 veta të cilët njëherazi edhe ishin përfitues të bursave e që duhej të punonin për AKZHIE për 3 vjet.
- ❖ Monitorimi i PVPE-së mbetet problem i madh. Stafi i mangët në numër ka shumë përgjegjësi dhe si pasojë mungon analiza mbi veprimet e PVPE-së. Vetëm njëherë në vit në rishikimin e PVPE-së vërehen veprimet që nuk janë përfunduar. Zyrtarët për integritet evropian në linjat ministrore nuk shtyjnë veprimet që të arrihen në kohën e paraparë me PVPE, përkundër faktit se kjo është përgjegjësi që rrjedh nga termet e referencës së punës së tyre.
- ❖ Zëvendëskryeministri përgjegjës për Integritet Evropian në qeverinë e Kosovës nuk raporton me shkrim në komisionin për integritet evropian në Kuvendin e Kosovës (KIEKK), edhe pse një gjë e tillë kërkohet nga komisioni.
- ❖ PVPE si dokument Strategjik asnjëherë nuk ka qenë temë e debatit e replikave apo e diskutimit në mënyrë të veçantë nga asnjë deputet në Kuvendin e Kosovës.

- ❖ Komunikimi në aspektin teknik dhe administrativ ndërmjet AKZHIE-së dhe Kuvendit, më saktësisht KIEKK-së pothuajse nuk ekziston. Gati të gjithë deputetët e këtij komisioni e konfirmojnë një gjë të tillë. Deputetët e këtij komisioni nuk pranojnë asnjë e-mail, telefonatë, apo ndonjë shkëmbim zyrtar të informatave prej AKZHIE-së
- ❖ Komunikimi i jashtëm apo me publikun i AKZHIE-së mungon tërësisht. AKZHIE nuk ka zyrtar për komunikim me media duke ikur kështu nga transparenca dhe informimi i publikut të gjerë. Edhe pse një pjesë e mirë e stafit ishin hedhur në grevë duke bojkotuar punën në Janar të këtij viti, agjencioni më saktësisht qeveria kanë heshtur duke i ikur kështu nga transparenca dhe duke fshehur zhvillimet e brendshme.
- ❖ Ministritë përkatëse nuk janë duke treguar interesimin e duhur për dokumentin strategjik PVPE. Kjo vërtetohet me faktin se një pjesë e mirë e sekretarëve permanent shpesh bojkotojnë pjesëmarrjen në diskutimet për PVPE.
- ❖ Komisioni për Integritet Evropian në Kuvendin e Kosovës nuk bënë mbikëqyrjen e zbatimit të PVPE-së edhe pse kjo është përgjegjësi e tyre. Asnjë raport nuk është nxjerrë nga ky komision që do të tregonte shkallën e zbatimit të PVPE-së. Për më tepër zyrtarët për integritet evropian në linjat përkatëse pohojnë se asnjëherë asnjë deputet i këtij komisioni nuk i ka vizituar në vendin e tyre të punës.
- ❖ Ligjet për gjyqësorin të kritikuar nga raporti i fundit i progresit, ende nuk janë miratuar nga Kuvendi. Këto ligje janë: Ligji për gjykata, Ligji për prokurorinë, Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Këshillin prokurorial. Disa prej këtyre ligjeve figurojnë si veprime për t'u zbatuar qysh nga PVPE 2006.
- ❖ Ligjet për gjyqësorin, tani të finalizuara, presin miratimin nga qeveria, për ti hapë rrugë miratimit në Kuvend. Këto ligje kanë hasur në pengesë të miratimit për shkak të përmbajtjes së tyre. Ndër shkaqet kryesore janë pagat e larta për gjykatës që thuhet se rëndojnë buxhetin e Kosovës.
- ❖ Ligji për gjykatat parasheh edhe krijimin e gjykatave të reja, mirëpo në disa raste mungon infrastruktura përkatëse, si psh. Me ligj parashihet krijimi i gjykatës së apelit mirëpo nuk ekziston asnjë objekt në të cilin është paraparë të vendoset kjo gjykatë, gjë

që pamundëson zbatimin e ligjit në fazën e parë. Vështirësi duket se do të krijojë edhe shkrirja e gjykatave të qarkut dhe atyre komunale në gjykata themelore. Vështirësia qëndron në faktin e mungesës së objekteve adekuate të cilat do të mundësonin punë profesionale dhe hapësirë të mjaftueshme për stafin.

- ❖ Ligjet mbi gjyqësorin janë draftuar si ligje në pako dhe janë dorëzuar të tilla. Diskutimi dhe debati gjatë hartimit të këtyre ligjeve ka munguar. Vetë Këshilli Gjyqësori i Kosovës dhe Oda e Avokatëve nuk janë përfshirë sa duhet në hartimin e këtyre ligjeve, apo edhe ekspertët juridik në vend. Ekspertët
- ❖ E kritikuar nga Raporti i Progresit, pjesëmarrja e ministrave në seanca parlamentare edhe pse është përmirësuar me miratimin e planit të ri të punës së Kuvendit, prapë mbetet masive vetëm në fillim, kurse nga mesi pothuajse të gjithë ministrat lëshojnë kuvendin.

Falënderojmë për kontributin e tyre dhënë në këtë raport:

Demush Shasha – Drejtor i Drejtoratit për Menaxhimin e Procesit të Stabilizim Asocimit

Besim Kajtazi - Drejtor i zyrës Ligjore në MSHP-së, respektivisht në Ministrinë për Administratë Publike.

Shkelzen Maliqi- Drejtor i zyrës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë.

Naser Rugova – Anëtar në Komisionin e Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian dhe njëherazi deputet në këtë Kuvend nga radhët e LDD-së.

Bajram Kosumi- Ish kryeministër i Qeverisë së Kosovës, anëtar në Komisionin për legjisllacion në Kuvend të Kosovës nga radhët e AAK-së.

Friederike Wünschmann- Zyrtare në Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë.

Ibrahim Makolli- Shef i Grupit Parlamentar të AKR-së dhe anëtar i Komisionit për Legjisllacion në Kuvend të Kosovës.

Arta Vllasaliu- Zyrtare për partneritet Evropian në zyrën për Integritet evropian pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Besim Kamberaj – Drejtor i Departamentit për Reforma në Pushtetin Lokal dhe Integritet Evropian në Ministrinë së administrimit të Pushtetit lokal.

Lulëzim Beqiri- zyrtar për integritet evropian në zyrën për integritet evropian në Ministrinë e drejtësisë.

Aishe Ramadani- Zyrtaren për Informim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Bahri Hyseni- Kryetar i Komisionit për Legjisllacion në Kuvend të Kosovës.

Vedat Maxhuni- Zyrtar në zyrën për Integritet evropian në Ministrinë për Kthim dhe Minoritete.

Tom Gashi- Avokat dhe njohës i çështjeve juridike dhe sistemit të drejtësisë në vend.

Arian Gola- Udhëheqës i zyrës për Integritet Evropian në Ministrinë për administratë publike.

Fitim Sadiku – Ushtrues i detyrës së sekretarit të përhershëm në Ministrinë për Administratë Publike (ish MSHP-së)

Besnik Tahiri – Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Qeverisje Lokale

Armend Rugova - Koordinator i Njësisë për të Drejtat e Njeriut në MAP

Dokumentet e konsultuara gjatë procesit të monitorimit të PVPE-së

- Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2008 (PVPE)
- Propozim Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Vitin 2008
- Plani për Integrimin 2008-2010.
- Raporti i Progresit 2008
- Strategjia për reformën në administratën publike
- Procesverbalet nga Takimet Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit për Kosovën.
- Vendimet e Qeverisë së Kosovës
- Komunikatat e Komisionit Evropian dhe Konkluzionet e Këshillit Evropian
- Draft ligji për këshillin gjyqësor të Kosovës
- Draft ligji për këshillin prokuroria të Kosovës
- Draft ligji për gjykatat e Kosovës
- Draft ligji për prokuroritë e Kosovës
- Draft ligji për Qeverinë e Kosovës
- Raporte mbi pasqyrat tabelore me të dhëna të te punësuarave në sektorin e shërbyesëve civil të Kosovës
- Raporte për strukturat për postet udhëheqëse në Ministri, strukturat etnike dhe gjinore në Institucionet e Kosovës.
- Strategjia legjislative e Qeverisë së Kosovës për vitin 2009.
- Buletinet informative të komisionit për Integritet Evropian në Kuvend të Kosovës.
- Raporte nga OJQ-të tjera vendore e ndërkombëtare mbi procesin e integritetit evropian të Kosovës.